



**Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 665/25 Dt. 31.12.2025

PLANI I TAKIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2026

Hyrja

Plani i Takimeve Publike për vitin 2026 paraqet një angazhim të vazhdueshëm të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, për forcimin e dialogut të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe rritjen e transparencës në qeverisjen lokale. Takimet publike janë një mekanizëm thelbësor për informimin e qytetarëve mbi punën dhe prioritetet e institucionit komunal, si dhe për krijimin e një hapësire të hapur komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe qytetarëve.

Përmbajtja

Plani parasheh organizimin e një serie takimesh publike gjatë vitit 2026, të cilat do të mbahen në zona të ndryshme urbane dhe rurale të Komunës së Prizrenit. Në këto takime, Kryetari i Komunës do të raportojë për aktivitetet dhe rezultatet e punës së ekzekutivit komunal, projektet në realizim dhe planet zhvillimore për periudhën e ardhshme.

Takimet do të shërbejnë gjithashtu si platformë për dëgjimin e drejtpërdrejtë të kërkesave, shqetësimeve dhe propozimeve të qytetarëve, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të tyre në proceset vendimmarrëse. Organizimi i takimeve do të bëhet në koordinim me Njësinë për Komunikim me Publikun dhe drejtoritë komunale përkatëse, ndërsa për secilin takim do të mbahet procesverbal dhe do të publikohet njoftim zyrtar.

Arsyetimi

Organizimi i takimeve publike është i domosdoshëm për ndërtimin e një qeverisjeje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse. Përmes këtyre takimeve, Komuna e Prizrenit synon të rrisë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve lokale, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve publike dhe të sigurojë që politikën dhe projektet komunale të reflektojnë nevojat reale të komunitetit.

Takimet publike kontribuojnë në forcimin e demokracisë lokale, duke u dhënë qytetarëve mundësinë të jenë pjesë aktive e vendimmarrjes dhe bashkëautorë në proceset e zhvillimit të kom

Baza Ligjore

Plani i Takimeve Publike për vitin 2026 është përgatitur në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht:

- **Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**, i cili garanton të drejtën e qytetarëve për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen lokale;
- **Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna**, që rregullon parimet dhe mekanizmat e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare;
- **Statutin e Komunës së Prizrenit**, i cili përcakton format e komunikimit dhe raportimit me qytetarët;
- **Rregulloren Komunale për Transparencë**, që obligon institucionet komunale të sigurojnë informim dhe konsultim publik të rregullt.

Në tabelën e mëposhtme, mund t'i shihni të dhënat për mbajtjen e takimeve publike:

Nr	Përgjegjës për organizim e konsultimit	-Titulli i Projekt Dokumenti	-Publikimi i njoftimit -Mbajtja e takimit -Vendi i mbajtjes	Koha e pritshme për miratim të aktit në kuvend	Metodat tjera krahas me platformat online	Buxheti	-Procesmbajtëse -Komunikimi me mediet
1	Zyra e Kryetarit -Kabineti Zyra për Informim	Takimi i parë publik me qytetarë	Qershor Salla e Kuvendit Komunal-Shtëpia e Bardhë	Nuk nevojitet miratimi	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Kabineti i Kryetarit Ymer Berisha Haziz Krasniqi Adelina Hoxhaj
2	Zyra e Kryetarit -Kabineti Zyra për Informim	Takimi i dytë publik me qytetarë	Dhjetor Salla e Kuvendit Komunal-Shtëpia e Bardhë	Nuk nevojitet miratimi	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Kabineti i Kryetarit Ymer Berisha Haziz Krasniqi Adelina Hoxhaj

Përfundimi

Plani i Takimeve Publike për vitin 2026 përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të qeverisjes së hapur dhe gjithëpërfshirëse në Komunën e Prizrenit. Përmes këtyre takimeve, Kryetari i Komunës, z. Shaqir Totaj, synon të sigurojë komunikim të drejtpërdrejtë dhe transparent me qytetarët, të rrisë llogaridhënien institucionale dhe të ndërtojë politika lokale në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Ky plan kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin demokratik dhe të qëndrueshëm të komunës.

Në takime publike mund të marrin pjesë:

Qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve/bashkësive lokale, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë/rejat, pensionistët/et, studentët/et, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Prizrenit, deputet/e, punonjësit e komunës, përfaqësuesit e partive politike dhe përfaqësuesit e mediave.

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net si dhe në formë fizike në këtë adresë: Rruga Adem Jashari Nr 275 Prizren 20000 (Shtëpia e Bardhë).

Përgjegjës për zbatimin e planit janë:

1.Kryetari i Komunës

2.Drejtoritë e Drejtorive Komunale

Përgatiti:

Haziz Krasniqi



Zyrtar i Lartë për Informim dhe Raportim

Zyrtar përgjegjës për Konsultime Publike